

PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE PËR AKTIVITETIN:

Menaxhimi i mbetjeve

ID 5.10/b. “Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme që nuk përmendet më lart”

(sipas shtojcës 1 të Ligjit 52/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.10448, datë 14.07.2011, të ndryshuar”)

PERSON FIZIK: “Besim Përgjegja”

NIPT: M18025301T

VENDNDODHJA: Lezhe Mamurras FUSHE-MAMURRAS Lagje 8, Rruga Stacioni i Trenit, ZK Nr. 1676, Pasuria Nr. 107/19 4702.

1. PROFILI I OPERATORIT

Operatori "**Besim Përgjegja**" është regjistruar ne QKB me date **25/06/2021**, me **Forme Ligjore si Person Fizik**, me **NIPT: M18025301T**.

Personi fizik "Besim Përgjegja" do te aplikojë per Leje Mjedisit Tip B.

Klasifikimi bazuar ne ligjin 10448 datë 14.07.2011, të ndryshuar:

Referuar shtojces 1 te ligjit 52/2020 "PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10448, DATË 14.7.2011, "PËR LEJET E MJEDISIT", TË NDRYSHUAR", aktiviteti *Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme* klasifikohet per tu pajisur me Leje Mjedisit te tipit B (Shtojca 1, Magazinim I mbetjeve; **ID 5.10/b "Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme që nuk përmendet më lart"**)

2. OBJEKTIVAT E AKTIVITETIT:

Objektivi i pare i ketij aktiviteti do te jete te identifikojë ndikimet e mundshme negative mjedisore ketij instalime te cilat jane:

- Emetimet ne ajer dhe zhurmat;
- Ndikimi ne flore/faune;
- Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti i punetoreve;
- Ndikime social-ekonomike;
- Ndikim ne cilesine e jetes ne qendrat e banuara;
- Ndikim ne rritjen e trafikut rrugor;
- Ndikim ne peizazhin e zones;

-Objektivi i dyte i ketij aktiviteti eshte gjetja e alternativave qe jane me miqesore me mjedisin.

3. VENDNDODHJA E AKTIVITETIT

Vendndodhja e aktivitetit është: **Lezhe Mamurras FUSHE-MAMURRAS Lagje 8, Rruga Stacioni i Trenit, ZK Nr. 1676, Pasuria Nr. 107/19 4702.**

Objekti ne dispozicion te stacionit te transferimit te mbetjeve jo te rrezikshme identifikohet sipas ortofotos se meposhteme:



Koordinatat sipas Gauss Kruger

Nr.	X	Y
1.	4389389.23	4605534.21

4. PERSHKRIMI AKTIVITETIT

ID 5.10/b “Stacion transferimi per mbetje jo te rrezikshme qe nuk permenden me lart”.

Stacioni I transferimit te mbetjeve eshte nje stacion I centralizuar, ku mbetjet shkarkohen nga makinat me te vogla te grumbullimit te mbetjeve dhe ringarkohet perseri ne makina me te medha, per te mundesuar transportimin ne distanca te largeta, ne venddepozitimet finale apo impiantet e trajtimit te tyre. Ky transferim I mbetjeve shpesh here shoqerohet me aktivitete per vecimin, ndarjen apo perpunimin e mbetjeve ne funksion te teknologjise se perpunimit apo perdorimit te metejshem te tyre. Ne rastet kur mbetjet nuk vijne te ngjeshura ato mund te kompresohen brenda stacionit te transferimit. Kufizimet teknike te makinave te vogla te grumbullimit te mbetjeve dhe kosto efektive e transportit te mbetjeve me makinat e medha, I ben stacionet e transferimit te jene zgjidhje optimale dhe e zbatueshme.

Problemi kryesor ne ndertimin e nje stacioni transferimi eshte gjetja e nje zone te pershtatshme. Personi fizik merret vetem me grumbullimin e mbetjeve jo te rrezikshme, ndarjen e tyre sipas llojit dhe me pas sistemimi I tyre ne ambientet e shoqerise, ku me pas terhiqen nga kompani te tjera te interesuara per to.

4.1. Qendrueshmeria e stacionit te transferimit

Stacionet e transferimit ofrojne:

- perfitime ekonomike si kosto te ulet te grumbullimit te mbetjeve (sepse punetoret shpenzojne me pak kohe per te udhetuar per ne zonen e depozitimit)
- reduktimin e lendes djegese te konsumuar
- kostot e mirembajtjes per makinat e grumbullimit
- perfitime te tjera qe lidhen me rritjen e fleksibilitetit ne perzgjedhjen e zonave te depozitimit e mbetjeve
- mundesia per te ricikluar mbetjet ose kompostuar mbetjet ne stabiliment dhe mundesia per copetuar apo per te grimcuar mbetjet perpara depozitimit

4.2. Zona e grumbullimit

Hapi I pare ne projektimin e nje sistemi te grumbullimi te mbetjeve fillon nga percaktimi I zonave te grumbullimit apo zonave ku ofrohet sherbimi per mbetjet, ku autoritetet locale planifikojne te ofrojne ose permiresojne kete sherbim. Autoritetet lokale duhet te percaktojne se ne cilat zona do te ofrojne sherbimin e grumbullimit te mbetjeve. Sa me e madhe zona e rigrumbullimit, aq me shume do te kushtojte sherbimi.

4.3. Procesi I funksionimit te instalimit

SKEMA E FAZAVE TË PROÇESIT INDUSTRIAL TË GRUMBULLIMIT DHE RECIKLIMIT



Fillimisht mbetjet qe vijne ne instalim kalojne ne peshore, ne te cilen merrret sasia e mbetjeve qe ka mjeti, per te cilen mbahen rekorde ne nje dokument te vecante. Pas kesaj mbetjet depozitohen ne sheshin e hapur te depozitimit. Mbetjet qe operatori grumbullon jane mbetje jo te rrezikshme, e thene kjo nuk kane ne perberje te tyre substance te rrezikshme edhe pse mund te bien ne kontakt me ujin.

Theksojme faktin se mbetjet e depozituara ne kete shesh qendrojne per nje kohe shume te shkurter, sepse pas depozitimit ne sheshin e hapur ato diferencohen dhe terhiqen nga kompani riciklimi.

Sheshi I depozitimit ne output perbehet nga konteniere, ne te cilet vendosen mbetjet e seleksionuara dhe I shtruar me beton, ne menyre mos renien ne kontakt me ujin apo me ndonje faktor tjetër atmosferik, I cili mund te pasohet me ndikime te lehta ne mjedis. Mbetjet ne kete shesh depozitimi output nuk qendrojne gjate, pasi ngarkohen me mjetin e transportit per ne stacionin perfundimtar te trajtimit (landfill).

5. IDENTIFIKIMI DHE VLERSIMIT I SHKARKIMEVE NE MJEDIS

Shkarkime ne ajer- Shkarkime te lehta ne ajer do te konsiderojme gazet, te cilat gjenerohen nga motoret me djegie te brendhsme, qe perdorin automjetet ne sherbim te kompanise. Keto shkarkime do te jene te uleta ne krahasim me cdo aktivitet te kesaj natyre

Shkarkime ne ujera- Do te kemi vetem nga sherbimet higjieno-sanitare, te cilat nuk ndikojne ne mjedisin ujqor prites.

Shkarkime ne toke – Ne kete aktivitet nuk mund te kemi ndikime ne toke per aq kohe sa operatori ploteson gjithë standartin per zhvillimin e aktivitetit. Aktivitete te tilla ndihmojne ne

miremenaxhimin e mbetjeve dhe jane shume te rendesishme, duke shoqeruar me nje impakt pozitiv si nderlidhes te kompanive ricikluese.

Zhurmat- Zhurma mund te konsiderohen vetem ato te cilat gjenerohen gjate transportit te mbetjeve nga automjetet perkatese. Keto shkarkime jane ne vlera normale krahasuar me aktivite te po te njejtës natyre. Largesia nga zonat e banuara eshte e konsiderueshme dhe nuk pritet te kete ndikim drejtperdrejte ne to.

Mbetjet e ngurta- Mbetjet e ngurta dalin si rezultat I aktivitetit te punonjesve do te grumbullohen ne vendet e caktuara nga shoqeria dhe me pas do te dergohen per ne vendet e caktuara nga pushteti vendor. Do te punohet qe keto mbetje te ndahen qe ne burim dhe do te perdoren konteniere hermetike qe te evidentohen aromat e pakendeshme qe mund te vijne si pasoje e kushteve klimatike.

Ndikime ne flore dhe faune – Zona ne te cilen ushtrohet aktiviteti eshte nje zone ne te cilen nuk takohen elemente te spikatur te flores. Perreth kesaj zone mund te hasim bimesi te ulet dhe barishte. Aspekti faunistik paraqet nje larmi biologjike te varfer. Zhvillimi I ketij aktiviteti nuk paraqet asnje ndikim negative ne flore apo faune.

Ndikimi social-ekonomik – Me operimin e ketij aktiviteti pritet te kete nje impakt pozitiv ne ekonomine e vendit. Operatori do te punesoje personel te zones, duke bere te mundur rritjen e nivelit ekonomik dhe te punesimit.

Person fizik

“Besim Përgjegja”